


Çfarë është biodiversiteti



Biodiversiteti është **Natyra**, ose ajo pjesë e saj që është e gjallë! Natyra është hapësira fizike ku ne jetojmë dhe peizazhet e paprekura që na mahnisin, biodiversiteti është ajo pjesë që e ngjyros atë, në kuptim të drejtpërdrejtë.

Biodiversiteti përfshin të gjithë varietetin e **organizmave** të gjallë në të gjitha format që natyra ka krijuar, si llojet detare, të ujrave të ëmbël, lloje tokësorë, etj. Ai përfshin nga **mikroorganizmat** më të vegjël, si bakteret, deri te balenat gjigande që njihen si llojet më të mëdhaja që jetojnë në planetin tonë, e që gjithashtu vizitojnë Shqipërinë.

biodiversiteti është qëndrueshmëri



Më konkretisht, biodiversiteti është ajo çfarë bën të mundur jetën tonë në planetin Tokë! Të lidhura në një **zinxhir** ushqimor që bazohet në ndërveprim për të mbijetuar, llojet e planetit tonë krijojnë një **balancë** të përkryer që përketshet në shërbime të pazëvendësueshme. Këto krijesa bëjnë të mundur **lulëzimin e ekosistemeve** që prodhojnë

oksigjen, parandalojnë përmbytjet dhe erozionin, pastrojnë **ajrin** dhe **ujin**, polenizojnë bimët, kontrollojnë sëmundjet, trajtojnë ujërat e pista, detoksifikojnë komunitetet bimore dhe shtazore, si dhe mbështesin jetën e njerëzve.

Duke e mbajtur këtë motor jete në lëvizje, biodiversiteti mbështet qëndrueshmërinë ekonomike të njerëzve, duke siguruar vazhdimisht lëndët e para që përdoren për konsum dhe prodhim. Shumë **mënyra jetese**, si jeta në fermë, e peshkatarëve, e përpunuesve të lëndëve drusore, varen nga shërbimet që ofron biodiversiteti. Patjetër, ka shumë komunitete të tjera që varen nga po të njëjtat shërbime. Këtë po mendoje, apo jo?

Ndërkohë që infrastruktura gri turistike po e humb vlerën dita - ditës, njerëzit gjithnjë e më tepër janë duke kuptuar që **turizmi natyror** është i paçmueshëm, duke krijuar një lloj të ri të turizmit elitar. Shumë veprimtari rekreative varen nga biodiversiteti, si kundrimi i shpendëve, ngjitja e maleve, kampingjet në natyrë apo peshkimi, duke i kthyer komunitetet lokale në menaxhues të **burimeve natyrore**, si dhe ruajtës të biodiversitetit unik që i rrethon.

biodiversiteti është histori



Luanët, bizonët, shkabat mjekroshe, etj., përbëjnë vetëm disa nga llojet që janë zhdukur në territorin

shqiptar. Është e vështirë të imagjinosh tanimë, sesi **peizazhi** i vendit tonë ka qenë i përshtatshëm për këto lloje. Akoma më tej, **identiteti kulturor** është shumë i lidhur me biodiversitetin.

Ngjarje të rëndësishme ku përfshihen edhe aspekte të biodiversitetit janë një pjesë e rëndësishme e historisë së secilit vend. Një prej këtyre ngjarjeve të **natyrës së Shqipërisë** ka qenë kur 8 balena gjigande u gjendën në brigjet e plazhit të Durrësit, në vitin 1958. Kjo ngjarje përbën një moment shumë të rëndësishëm të trashëgimisë sonë natyrore, që tregohet me kërshëri në Muzeun e Shkencave të Natyrës nëpërmjet skeletit të një prej balenave.

Kultura në shumë rajone të largëta është e lidhur me biodiversitetin, për arsye të një lidhjeje simbiotike ndërmjet habitateve natyrore dhe krijimtarisë kulturore, si dhe ndërmjet ekosistemeve dhe identitetit kulturor; Patjetër, rregullat fetare dhe ritualet shpesh e forcojnë këtë marrëdhënie, duke promovuar një etikë ruajtëse.

Folklori, mitet, poemat, identiteti, janë vetëm disa pjesë të kulturës ku biodiversiteti ndërlidhet ngushtësisht. Në periudhat parahistorike, njerëzit apo vendet shpesh emërtoheshin sipas llojeve të biodiversitetit, si p.sh. Porta e Luanit në Butrint. Por edhe në kohët e tanishme,

Shqipëria ende quhet “Toka e Shqiponjave”.



biodiversiteti

është e ardhmja



Ndërkohë që katastrofat mjedisore kërcënojnë vazhdimisht dhe **njerëzimi** është duke u përballur me pasojat e **ndryshimeve klimatike**, njerëzimi duhet të veprojë sipas mësimave të marra. Përpjekjet për të ruajtur dhe ristauruar zona të rëndësishme për biodiversitetin, do të krijojnë **ekosisteme** të qëndrueshme, si dhe zona buferike të cilat do të parandalojnë sëmundjet dhe të ofrojnë të mira. Megjithatë e konsideruar si larg shtëpive tona, e gjitha puna që llojet e biodiversitetit bëjnë për ne, duhet të na bëjë të kuptojmë që ata janë bashkëpunëtorët më të ngushtë për sigurimin e jetës në tokë.




Për momentin,
shijoni një pjesë
të këtyre vlerave,
të sjella në zemër
të Tiranës nga fushata
“Shqipëria është
Biodiversitet”.



In partnership with

HEINRICH BÖLL STIFTUNG
The Green Political Foundation
TIRANA

Supported by



Ajencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



Funded by
the European Union



Embassy
of the Federal Republic of Germany
Tirana



AMBASSADE
DE FRANCE
EN ALBANIE
Egalité
Fraternité



ITALIAN AGENCY
FOR DEVELOPMENT
COOPERATION



vodafone



Çfarë është Biodiversiteti